


SË BASHKU E NDËRTOJMË



DEMOKRACINË

TË MIRAT QË NA I SJELL DEMOKRACIA

MILOT (15), JETA (14), BURIM (15), FLORIE (15), BESNIK (14)



Demokracia është formë e qeverisjes, ku qytetarët ushtrojnë sovranitetin e tyre përmes votës

Demokracia është formë e qeverisjes, në të cilën shumica e popullsisë ushtrojnë sovranitetin e tyre në vend. Fillimet demokratike janë në Greqinë e lashtë, qysh nga viti 507 para erës sonë.

Format e demokracisë janë: demokracia përfaqësuese dhe demokracia e drejtpërdrejtë.

Në demokraci, ne si qytetarë të Republikës së Kosovës e kemi të drejtën e votës dhe pasi që kemi sistem parlamentar, ne i votojmë deputetët, ndërsa ata në emrin tonë e zgjedhin Presidentin.

Demokracia kërkon një marrdhënie besimi ndërmjet qytetarëve dhe shtetit. Legjitimiteti demokratik ka të bëjë me aprovimin ose thjeshtë me pranimin e statutit të formës së shtetit, që do të thotë se, një vendim që merret nga përfaqësuesit e shtetit dhe miratohet në

Kuvend, hyn në fuqi dhe e merr formën e zbatimit. Por, nëse qytetarëve nuk iu pëlqen ai vendim, në bazë të legjitimitetit demokratik ne kemi të drejtë ta ndryshojmë ose ta largojmë atë ligj.

Pra, demokracia përfaqësuese është një formë e qeverisjes ku qytetarët shprehin vullnetin e tyre përmes përfaqësuesve të zgjedhur.

Një prej elementeve të demokracisë është barazia, për shembull pesha e votës nuk dallon, qoftë ajo votë e dhënë prej grave apo prej burrave. Liria është e drejtë e çdo qytetari të një vendi për të lëvizur lirshëm, sikurse ne në Kosovë që nuk pengohemi dhe lëvizim lirshëm brenda shtetit tonë. Element tjetër i demokracisë është solidariteti, ku ne si individë mund të shprehim dëshirën dhe t'i ndihmojmë të tjerët në rast nevojë. Për shembull, nëse një nxënës në klasën tonë ka nevojë për ndihmë në lëndën e matematikës, ne nxënësit e tjerë i ndihmojmë me shumë kënaqësi.



Të gjithë e kemi të drejtën e shkollimit pa asnjë dallim




Autorët e artikullit

ZGJEDHJA ËSHTË E ARDHMJA

AJSHE (14), FITORE (15), RINA (15), LENDRIT (14), HASHIM (14)



Kandidati për deputet duke treguar planprogramin e tij



Në procesin zgjedhor të gjithë jemi të barabartë, pa dallime

Voto më të mirin për një të ardhme më të mirë.

E pikërisht artikulli ynë flet për votën, procesin zgjedhor dhe rëndësinë që ka vota

Ne në përditshmëri ballafaqohemi me zgjedhje të ndryshme. Këto zgjedhje janë të lehta krahasuar me procesin zgjedhor. Pse mendojmë kështu? Kjo për shkak se, nëse ne zgjedhim një film për ta shikuar dhe ai film nuk na pëlqen edhe aq shumë, ne vetëm mund ta ndërrojmë kanal televiziv. Në këtë rast ne nuk e dëmtojmë askënd.


Kurse, në procesin zgjedhor, ne nuk zgjedhim film apo libra, ne zgjedhim përfaqësuesit tanë. Këta përfaqësues kanë për detyrë të udhëheqin vendin tonë. Prandaj, në rast se ne bëjmë zgjedhjen jo të duhur, udhëheqësin nuk mund ta ndryshojmë siç bëjmë me kanal televiziv, kur nuk na pëlqen një film. E shihni pra sa të rëndësishme janë zgjedhjet dhe vota e gjithsecilit nga ne? Procesi zgjedhor është procesi më i rëndësishëm që ndodh në një vend demokratik.

Gjatë këtij procesi ne e gëzojmë lirinë e votës. Në vendin tonë kemi dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet parlamentare dhe ato komunale. Në zgjedhjet parlamentare ne i zgjedhim deputetët. Ndërsa në zgjedhje komunale i zgjedhim kryetarët e komunave përkatëse. Ndonëse ne zgjedhim gjatë tërë kohës, të drejtën për të marrë pjesë në procesin zgjedhor e kemi nga mosha 18 vjeçare. Arsyeja pse kjo ndodh është për shkak se duhet të jemi të pjekur kur vendosim se kush e meriton votën tonë.





Siç po e shihni, procesi zgjedhor luan një rol vendim-marrës në jetën tonë. Megjithatë, jemi ne ata që vendosim në këtë proces. Vota jote bën ndryshim në vendin tonë. Mos hezito të dalësh dhe të votosh. Kështu do të veprojmë edhe ne, derisa me votën tonë sjellim ndryshimin e nevojshëm.



Autorët e artikullit




Voto edhe ti



KUVENDI, VENDI KU MIRATOHEN LIGJET

VALDRIN (15), BLEART (15), KASTRIOT (14), ORGET (14), ALBANA (15), DJELLZA (15)




Pse është i rëndësishëm Kuvendi i Republikës së Kosovës? Sa deputetë janë në Kuvend? Cili është roli i Kryetarit të Kuvendit dhe disa informacione të tjera do të lexoni në artikullin më poshtë

Kuvendi është institucioni më i lartë ligjvënës i një shteti. Në Kuvend propozohen dhe miratohen ligjet më të rëndësishme për vendin tonë. Ligjet që merren në Kuvend ndikojnë në zhvillimin dhe në të ardhmen e vendit. Kuvendi i Kosovës i ka gjithsej 120 deputetë, roli i të cilëve është përfaqësimi i popullit në mënyrën më të mirë të mundshme. Megjënëse Kuvendi është institucion demokratik, ai i zbaton parimet e demokracisë të cilat janë: liria, paqja, toleranca, sovraniteti, barazia, etj. Me këtë kuptojmë se në Kuvend të gjithë janë të lirë dhe të barabartë. Po ashtu, pjesë përbërëse e Kuvendit përveç deputetëve nga kombi shqiptar janë edhe deputetët nga komunitetet jo shumicë të cilët kanë po ashtu të drejtën e shprehjes së lirë.

Ligjet që miratohen në Kuvend kanë ndikim të madh në jetën e secilit qytetar, për shembull ligjet për edukim, shëndetësi, infrastrukturë, ekonomi, etj.

Funksionet kryesore të Kuvendit janë: funksioni legjislativ, sepse në Kuvend miratohen ligjet, funksioni përfaqësues, sepse deputetët përfaqësojnë popullin si dhe funksioni kontrollues, sepse Kuvendi kontrollon Qeverinë. Në Kuvend zakonisht seancat mbahen ditën e enjte dhe pikat e rendit të ditës caktohen nga Kryesia e Kuvendit. Kryetari i Kuvendit i udhëheq seancat plenare.

Këto ishin disa informata rreth punës që e kryen Kuvendi i Kosovës, por asnjëherë mos harroni se ne jemi ata që kemi ndikim në vendin tonë, sepse vota jonë vendos se kush do të na përfaqësojë dhe kush do të flasë në emrin tonë në Kuvend. Prandaj, është shumë e rëndësishme që të gjithë t'i zbatojmë parimet e demokracisë.



Votimi është proces demokratik



Gazetarët e demokracisë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Nazim Gafurri“
Klasa: IX-2
Vendi: Prishtinë